

VENDIM
Nr. 471, datë 30.7.2021

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I GODINËS QENDRORE ADMINISTRATIVE TË
SHËRBIMEVE TË QENDËRZUARA TË TRANSPORTIT RRUGOR SHQIPTAR
DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT
RRUGOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i godinës qendrore administrative të shërbimeve të qendërzura të transportit rrugor shqiptar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 26 904 342 (njëzet e gjashtë milionë e nëntëqind e katër mijë e treqind e dyzet e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 26 904 342 (njëzet e gjashtë milionë e nëntëqind e katër mijë e treqind e dyzet e dy) lekësh të përballohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I GODINËS ADMINISTRATIVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sip. e prekur (m²)	Çmimi truall lek/m²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë
1	Arben	Sadik	Vathi	Truall	8250	1/10	3080	874	30783	26,904,342	- Në bazë të vendimit nr. 12259, datë 22.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë njihet Laura Lera trashëgimtare e Hasan Haxhi Ruka në 1/16 pjesë. - Me referencën 14198, vendim gjykate të apelit 3232, datë 26.9.2014 njihet si trashëgimtare e Hasan Ruka dhe Jondia Vrapit me 1/16 pjesë. - Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa me nr. pasurie 1/1045-ND (pallat) - Vendoset masa e sekuestros konservative vetëm për pjesën e z. Enver Ruka nga përmbartues gjyqësor Ardit Firaj
	Besim	Hamdi	Ruka								
	Dashamir	Muhamet	Ruka								
	Fatbardha	Muhamet	Tutaj								
	Fatnir		Alla								
	Fatnmira	Sadik	Vathi								
	Hatixhe	Eqerem	Çaushi								
	Hatixhe		Ruka								
	Haxhi	Sadik	Vathi								
	Haxhire	Muhamet	Çaushi								
	Ilirjan	Eqerem	Ruka								
	Jemine		Ruka								
	Myzejen		Ruka								
	Nazmi	Sadik	Vathi								
	Nuri	Hamdi	Ruka								
	Paqize		Kulluku								
	Pranvera	Eqerem	Spartaku								
	Shpresa	Muhamet	Ruka								
	Shqiponja	Muhamet	Osmanlliu								
Suzana	Eqerem	Ruka									
Ylvis		Pinari									
Laura		Lera									
Jonida		Vrapit									
Enver		Ruka									
2	Shtet			Shesh	8250	1/1006	658	658	30783	0	Mbi këtë truall ndodhet objekti nr. 1/926-ND VOL.30, FQ.183
3	Shtet			Shesh	8250	1/1007	318.39	318.39	30783	0	Mbi këtë truall ndodhet objekti nr. 1/926-ND VOL.30, FQ.184
4	Shtet (Republika e Shqipërisë)			Ndërtesë	8250	1/926-ND	429	429	30783	0	VKM 226, datë 23.4.2004 Nën administrimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, DPSHTRR-së
Vlera totale e shpronësimit										26,904,342	

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr.89, datë 3.2.2016.